

Data 30.12.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Monitorim i të gjithë sistemeve Datacenter (SIEM)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime kontrolli dhe monitorimi 71700000-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 14.895.720 (katërmëdhjetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë **pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; 297.914,4 (dyqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e katërmëdhjetë presje katër).*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 43, pika 1, pika 2 b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021,2022,2023) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar.

Nëse kërkohen bilance të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 19, pika 2, të VKM Nr. 498, datë 1.8.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, të ndryshuar.

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2024)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.2.4. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2024 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të ofruara, ose,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të ofruara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$14.895.720 \times 30\% = 4.468.716$$

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën përkatëse të vlefshme ISO në përputhje me objektin e prokurimit, (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar) të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituar nga DPA ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- **ISO 9001:2015** ose të përditësuar për Menaxhimin e Cilësisë në të njëjtën fushë me objektin e prokurimit;
- **ISO 27001:2022** ose të përditësuar për Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit;
- **ISO 20000-1:2018** ose të përditësuar për Menaxhimin e Shërbimeve TI;

Shënim: Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Si dhe nisur nga proceset e punës kritike, rëndësisë së sistemit dhe shërbimeve që ai ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik proceset e punës së tij, ti bazojë në standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtësi, efikasitet të shërbimeve të ofruara.*

- *Sistemi i menaxhimit të cilësisë është i nevojshëm pasi siguron që operatori zotëron aftësitë*

për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e AK përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij.

- *Menaxhimi i shërbimit IT është i nevojshëm pasi siguron që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektivisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre. Kjo na siguron që implementimi i projektit do të bëhet sipas standardeve përkatëse.*
- *Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit është i nevojshëm pasi siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përfaqje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria, çka nisur nga rëndësia dhe sensitiviteti i të dhënave që menaxhohen nëpërmjet sistemit objekt prokurimi, është një element jo vetëm i domosdoshëm por kritik.*

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë që ka jo më pak se **10 (dhjetë)*** punonjës të siguar, ku të përfshihen jo më pak se **5 (pesë)* Inxhinierë/Specialiste** të diplomuar në Shkenca Elektronike / Teknologji Informacioni / Informatike / Informatike Ekonomike / Mekatronike / Telekomunikacion, ku të vërtetohet nëpërmjet: **diplomës.**

***Shënim:** Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhën e 3 mujorit të fundit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listëpagesave.

***Shënim:** Me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe parandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime, etj).

***Shënim:** Kriteret për punonjësit në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomike do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Në rastet kur Operatori Ekonomik do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 pika (4) të LPP, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.” si dhe nisur nga rëndësia e këtij projekti, i cili përveç veprimtarisë funksionale të tij ka impakt të drejtpërdrejtë në një numër shumë të lartë sistemesh të tjera të cilët ofrojnë shërbime për qytetarët dhe bizneset.

2.4.2 Për të vërtetuar aftësitë dhe kapacitetet teknike të punonjësve, operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij :

- Të paktën 1(një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti **ose ekuivalente** (PMP ose ekuivalent)
- Të paktën 2(dy) punonjës të certifikuar për testimet e sigurisë së sistemeve (CEH, PenTest+ **ose ekuivalente**)
- Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar për Implementimin dhe Menaxhimin e Sistemeve të Sigurisë së Informacionit (CISM **ose ekuivalente**);
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Azure Solutions Architect Expert **ose ekuivalente**
- Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar për Sigurinë në Rrjetet Kompjuterike (CCNP Security **ose ekuivalente**);
- Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar për kontrollin e rrezikut të sistemeve të Informacionit. (CRISC **ose ekuivalente**);
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në integrimin e praktikave të sigurisë dhe forensic dixhital (CHFI **ose ekuivalente**);
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si Arkitektë Cybersecurity në nivelin Expert;
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si DevOps Engineer Expert
- Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar nga një entitet i njohur kombëtar/ndërkombëtar si Lead Auditor për standardin ISO 27001 për Sistemet e Menaxhimin të Sigurisë së Informacionit;

***Shënim:** Një punonjës mund të ketë më shumë se një certifikim.

***Shënim:** Kërkesat për certifikimet e mësipërme duhet të vërtetohen me Certifikatat ose Transkriptet përkatëse (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar).

***Shënim:** Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhën e 3 muajve të fundit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listëpagesave.

***Shënim:** Me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe parandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime, etj).

***Shënim:** Kriteret për punonjësit në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomike do të konsiderohen të përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Në rastet kur Operatori Ekonomik do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

1. Të paktën 1(një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente (PMP ose ekuivalent)

Argumentim: Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën një punonjës të certifikuar si menaxher projekti, për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të projektit sipas standardeve dhe praktikave më të mira botërore duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit. Një menaxher projekti është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të implementimit të një projekti, që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve

përkatëse, testimit, trajnimit dhe dokumentimit të projektit. Projekt menaxheri, duke marrë parasysh kompleksitetin e projektit, afatet kohore të kryerjes së shërbimit, shumëllojshmërinë e shërbimeve të kërkuara, do të sigurojë që çdo pikë e shërbimeve të kërkuara të kryhen me sukses dhe cilësi si edhe në kohë e afat sipas kërkesave të parashikuara nga AK.

2. Të paktën 2(dy) punonjës të certifikuar për testime sigurie sistemesh (CEH, PenTest+ ose ekuivalent)

Argumentimi: Përfshirja e dy punonjësve të certifikuar për Testime Sigurie Sistemesh në zhvillimin e projektit është e rëndësishme për të garantuar realizimin e suksesshëm të kërkesave të Autoritetit Kontraktor. Këta specialistë duhet të kenë njohuri të thella në strategjitë dhe metodologjitë e testimit, duke siguruar cilësi të lartë dhe performancë për të testuar dhe për të rekomanduar përmirësime të sistemit/eve të sigurisë. Përmes planifikimit dhe drejtimit të testimeve të sistemeve, ata duhet të sigurojnë identifikimin dhe korrigjimin e gabimeve përpara se ato të shkaktojnë dëme reale dhe serioze për institucionin. Punonjësit e certifikuar sipas këtij kriteri janë në gjendje të përdorin teknologjitë dhe mjete të specializuara për të zbuluar pikat e dobëta të sistemeve me qëllim parandalimin e incidenteve të sigurisë, duke reduktuar kështu ndikimin e mundshëm negativ në proceset e punës.

3. Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar për Implementimin dhe Menaxhimin e Sistemeve të Sigurisë së Informacionit (CISM ose ekuivalent);

Argumentimi: Kërkesa e paraqitur sipas këtij kriteri është e domosdoshme për AK, në mënyrë që ai të sigurohet se operatori ekonomik disponon në personelin e tij punonjës që kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të zhvilluar dhe menaxhuar një ambient apo program të sigurisë së informacionit, njohuri dhe aftësi të cilat do të bëjnë të mundur që të analizoheshin dhe detektoheshin dobësi të mundshme të ambientit të Autoritetit Kontraktor, gjë e cila në vetvete është dhe qëllimi kryesor i projektit.

Një punonjës i cili është i certifikuar sipas këtij kriteri, veç aftësive teknike implementuese, ka njohuri të thelluara dhe për qeverisjen IT, menaxhimin e incidenteve dhe menaxhimin e risqeve. Përmes këtij kriteri AK, kërkon gjithashtu të sigurohet se operatori ekonomik disponon kapacitetet e nevojshme për të suportuar institucionin me rekomandimet e nevojshme dhe të domosdoshme për të qenë në përputhshmëri 'compliant' me të gjithë standardet dhe praktikatat sikurse kërkohet në termat e referencës së procedurës.

4. Të paktën 1 (një) punonjësi të certifikuar për Azure Solutions Architect Expert ose ekuivalente

Argumentimi: Kërkesa e paraqitur sipas këtij kriteri është e domosdoshme për AK, në mënyrë që ai të sigurohet se operatori ekonomik disponon në personelin e tij punonjës që kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të zhvilluar dhe menaxhuar Active Directory lokalisht dhe cloud. Përfshirja e një eksperti të certifikuar Azure Solutions Architect Expert është jetike për organizatat që kërkojnë një menaxhim të integruar dhe të sigurt të infrastrukturës së tyre Active Directory (AD). Ky expert ben të mundur Integrimin e Active Directory, Optimizimin e strukturës dhe politikave të AD On-Prem, përfshirë menaxhimin

e përdoruesve, grupeve dhe rolit të politikave GPO (Group Policy Objects). Përmirësimin e mbrojtjes së aksesit përmes implementimit të Multi-Factor Authentication (MFA) dhe politikave të avancuara të sigurisë. Rikuperim të shpejtë dhe të sigurt të Active Directory në rast të incidenteve ose sulmeve kibernetike. Eksperti me këtë certifikatë ofron një urë të sigurt dhe të qëndrueshme midis infrastrukturës tradicionale dhe teknologjive moderne cloud, duke siguruar integritet, efikasitet dhe rritje të sigurisë për organizatën.

5. Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar për Sigurine ne Rrjeta Kompjuterike (CCNP Security ose ekuivalente);

Argumentimi: Baza kryesore ose themeli mbi të cilin janë të ndërtuara sistemet është rrjeti, pa të cilin të gjithë elementët do të ishin të izoluar dhe asnjë proces pune nuk do të mund të mbështetej siç duhet në sistemet e informacionit. Nisur nga ky fakt, AK vlerëson se kërkesa për operatorët ekonomikë për të pasur në stafin e tyre të paktën një punonjës sipas këtij kriteri është shumë e rëndësishme. Ky kriter, nuk lidhet më së shumti me proceset e testimeve dhe të analizimit të gap-eve të ambientit teknologjik të AK, por lidhet më së shumti me rekomandimet dhe masat që do të kërkohen për tu marrë nga AK në rast se do të konstatohen dobësi të rëndësishme në rrjet. Duke marrë parasysh se një punonjës i certifikuar sipas këtij kriteri ka njohuri të mira në instalimin dhe konfigurimin e rrjeteve, evidentimin e gabimeve në rrjet, mirëmbajtjen e rrjeteve, planifikimin dhe dizenjimin e rrjeteve, route-imin, AK vlerëson se do të përmbushen nevojat dhe kërkesat e tij për menaxhimin e një network-u pa gap-e dhe pa dobësi të cilat nëse nuk do të evidentohen do të përbënin një risk tepër të lartë për AK.

6. Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar për kontrollin e rrezikut të sistemeve të Informacionit. (CRISC ose ekuivalent);

Argumentimi: Nisur nga e gjithë baza ligjore kombëtare në fuqi por edhe duke u bazuar në praktikën dhe përvojat më të mira ndërkombëtare, menaxhimi i rrezikut është një proces dhe faktor kyç në menaxhimin dhe administrimin e cdo procedure pune që zhvillohet. Kur bëhet fjalë për sigurinë kibernetike ky proces merr një rëndësi dhe më të madhe dhe më jetike.

Menaxhimi i riskut dhe ngritja e sistemeve të nevojshme dhe të domosdoshme të kontrollit janë kritike dhe të padiskutueshme kur synohet për tu menaxhuar një ambient i shëndetshëm kibernetik. Përmes parashikimit të këtij kriteri të veçantë kualifikimi, AK kërkon të sigurohet se operatori ekonomik disponon të gjithë kapacitetet e nevojshme dhe ka në përbërje të tij staf i cili është i certifikuar dhe ka njohuri të thelluara për procesin e menaxhimit të riskut, qeverisjen e sistemeve të IT, dizenjimin dhe implementimin e sistemeve të kontrollit etj. AK vlerëson se, duke pasur punonjës të certifikuar sipas përcaktimeve të këtij kriteri, operatori ekonomik do të mundësojë dhe do të ofrojë për AK ekspertizën e nevojshme për të menaxhuar dhe mitiguar në mënyrë të suksesshme risqet duke i kategorizuar dhe administruar ato në bazë të një standardi apo

politike të qëndrueshme të menaxhimit të risqeve.

7. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar ne integrimin e praktikave të sigurisë dhe forensic dixhital (CHFI ose ekuivalente);

Argumentimi: Duke u nisur nga parimi i pranuar ndërkombëtarisht, që asnjë infrastrukturë apo ambient teknologjik nuk mund të jetë i mbrojtur 100% dhe nuk mund të garantohet paprekshmëria absolute e tij, por kushdo që menaxhon dhe disponon këto infrastruktura duhet të përgatitet për tu përgjigjur dhe për tu mbrojtur në mënyrën më të mirë të mundshme, përmes këtij kriteri, AK kërkon të sigurohet që operatori ekonomik do të disponojë kapacitetet e nevojshme teknike për të analizuar, vlerësuar dhe rekomanduar kundërmasat e nevojshme për tu përballur me çdo incident kibernetik të mundshëm në ambientin e platformës që është objekt i këtij prokurimi. Disponimi i një personeli të tillë do të provojë për AK se operatori ekonomik do të zbatojë detyrimet e tij kontraktuale duke integruar praktikat dhe standardet me fokus drejt ‘forensic dixhital’.

8. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si Arkitektë Cybersecurity në nivelin Expert;

Argumentim: Përfshirja e të paktën nëe punonjës të certifikuar si Arkitektë të Sigurisë Kibernetike në nivelin Ekspert është e domosdoshme për të siguruar një qasje efektive ndaj sigurisë së informacionit. Këta ekspertë kanë njohuri të thella në identifikimin e rreziqeve të sigurisë kibernetike, hartimin e strategjive për mbrojtjen e rrjetit dhe infrastrukturës së IT, si dhe përdorimin e teknologjive më të fundit për të parandaluar sulmet potenciale. Përfshirja e dy punonjësve të certifikuar si Arkitektë të Sigurisë Kibernetike në nivelin Ekspert rrit aftësinë për të përballuar sfidat e sigurisë kibernetike në një mënyrë proaktive dhe efektive, duke siguruar kështu që të dhënat dhe infrastruktura e informacionit të mbeten të sigurta dhe të mbrojtura në mënyrë të përhershme.

9. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si DevOps Engineer Expert

Argumentim:Përfshirja e të paktën nëe inxhinierëve të certifikuar si DevOps Engineer Expert është thelbësore për të garantuar një integrim efektiv të projekteve DevOps dhe mbrojtjen e sigurisë së informacionit. Ky ekspertë zotërojnë aftësi të avancuara në Identifikimin dhe minimizimin e rreziqeve teknologjike, përmes proceseve të automatizuara dhe qasjeve të sofistikuar CI/CD. Zhvillimin e strategjive të sigurta për menaxhimin e infrastrukturës IT në ambientet cloud dhe on-premises. Implementimin e teknologjive moderne të mbrojtjes, duke parandaluar cenueshmërinë ndaj sulmeve kibernetike.Përfshirja e nee profesionisti me këtë certifikatë përmirëson kapacitetet organizative për të adresuar sfidat komplekse të integritit DevOps dhe sigurisë së informacionit, duke siguruar një ekosistem të qëndrueshëm dhe të mbrojtur teknologjik.

10. Të paktën 1 (një) punonjës të Certifikuar nga një ent i njohur kombëtar/ndërkombëtar si Lead Auditor për standardin ISO 27001 për Sistemet e Menaxhimin të Sigurisë së Informacionit;

Argumentimi: Sipas asaj çka është përcaktuar në termat e referencës të këtij projekti, një ndër proceset më të rëndësishme të projektit është dhe procesi i auditimit, i cili bën një skanim të plotë

dhe të pavarur të situatës aktuale në ambientin teknologjik dhe organizativ të AK-së dhe rekomandon masat e nevojshme në rast se evidentohen problematika. Në vijim të procesit të zbatimit të projektit, sipas asaj çka përcaktohet në termat e referencës AK ka parashikuar edhe certifikimin e tij sipas standardeve ndërkombëtare. Në këtë rast standardin ISO 27001 për Sistemet e Menaxhimin të Sigurisë së Informacionit.

Nisur nga sa më sipër, certifikimi i kërkuar sipas këtij kriteri, siguron për AK, që operatori ekonomik disponon kapacitetet e nevojshme për të garantuar një proces auditimi korrekt, objektiv, profesional dhe që sjell për AK vlerën e nevojshme dhe të rëndësishme që ofron një proces auditimi i jashtëm nga një palë e tretë. Një punonjës i certifikuar si Lead Auditor është përgjegjës dhe zotërojnë njohuritë e nevojshme për të planifikuar në mënyrë të suksesshme, drejtuar dhe realizuar një proces të plotë dhe të vlefshëm auditimi, çka është një nga synimet kryesore që AK ka në këtë procedurë.

Njësia e prokurimit